



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:281913

Datë: 12.01.2024

Numri i dokumentit: 05184692

AA.nr.5/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N... Z..., nga Ferizaj, kundër të paditurës Oda e Mjekëve të Kosovës, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A... Sh... nga Mitrovica, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2526/2019, të datës 07.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Oda e Mjekëve të Kosovës të cilën me autorizim e përfaqëson av.A... Sh... nga Mitrovica, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2526/2019, i datës 07.11.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2526/2019, të datës 07.11.2022, nen pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N... Z.... Ndërsa nen pikën II të dispozitivit anulohet vendimi i të paditurës, Oda e Mjekëve të Kosovës Nr.Ref.11-1/2019 i datës 05.09.2019 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kurse nen pikën III të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar e të paditurës av. A... Sh... nga Mitrovica, për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2526/2019, duke vendosur në mënyrë meritore që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar apo të ndryshohet ashtu që çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Zyra e Rregullatorit për Energji, me vendimin me numër Nr.Ref.11-1/2019 të datës 05.09.2019, nën pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paraqitur nga N... Z..., ndërkaq vendimin disiplinor KE 50-1/2019 të datës 19.07.2019 të Këshillit Etik të Odes së Mjekëve të Kosovës vërtetohet.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Oda e Mjekëve të Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit me numër Nr.Ref.11-1/2019 të datës 05.09.2019, të Odes së Mjekëve të Kosovës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, me të cilën është kërkuar anulimi i vendimit të lartcekur. Me arsyetim se me vendimin e të paditurës, me Nr.REF.KE.50-1/2019 të datës 15.07.2019, Gjykata gjeti se nga e paditura, paditësi, si specialist i pediatriisë-neurologjisë i punësuar në Klinikën e Pediatriisë në QKUK, është shpallur përgjegjës sepse me datat 04, 06, 07 dhe 08 maj 2019 ka lëshuar dokumentacion shëndetësor duke përdorur faksimilen (vulën) e paautorizuar nga organi kompetentë i OMK në dosjet e pacientëve, duke vepruar kështu në kundërshtim me Kodin Etik dhe Deontologjinë Mjekësore. Ndërsa në procedurën sipas ankesës organi i paditur ka nxjerr aktvendimin përfundimtar me numër nr.ref.11-1/2019 me datë 05.09.2019 e të goditur me padi, përmes të cilit Gjykata vëren se është refuzuar ankesa e parashtruar nga paditësi N... Z... dhe është vërtetuar vendimi i lartcekur i shkallës së parë. Kështu, gjykata e shkallës së parë për të vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, i'u referua dispozitës së nenit 26 paragrafi 1 dhe 2 të Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, në të cilën është përcaktuar: 1. Në procedurë para Këshillit Etik të Odës, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën administrative, në lidhje me thirrjen e palëve, sigurimin e provave, dëgjimin e palëve, përgatitjen e procesverbaleve dhe procedurat tjera. 2. Anëtarit të Odës ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore doemos duhet ti mundësohet deklarimi dhe mbrojtja pranë këshillit etik. Më pas gjykata e shkallës së parë i'u referuar Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe atë dispozitës së neni 95 E drejta e dëgjimit dhe 96 Përfundime nga drejta e të dëgjuarit, në të cilat është përcaktuar: 95. 1. Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t'u dëgjuar. 2. Njoftimi, i paraparë me paragrafin 1 të këtij neni, do të përshijë informacionin mbi rezultatet e shqyrtimit administrativ, rezultatit e mundshëm të procedurës si dhe informacionin mbi mënyrën e ushtrimit të së drejtës së dëgjimit. 3. E drejta për t'u dëgjuar mund të ushtrohet me shkrim apo gojarisht dhe regjistrohet në procesverbal nga organi publik. 4. Kur dëgjimi ndaras i secilës prej palëve të përfshira, në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, është jopraktik për shkak të numrit të madh të palëve, dëgjimi do të zhvillohet në çfarëdo mënyre të përshtatshme të dëgjimit të përbashkët. Ndërsa neni 96 ka përcaktuar: 1. Vendimi mund të merret pa u dëgjuar pala në rast se: 1.1. rezulton qartë se vendimi përfundimtar do të jetë në favor të palës apo do të përbëjë miratimin e plotë të kërkesës së saj; 1.2. marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të një interesi publik, që mund t'i shkaktohet një dëm nga vonesa; 1.3. pala tashmë i ka shprehur plotësisht, gjatë procedurës, mendimet e veta rreth rezultatit

të shqyrtimit administrativ dhe rezultatit të mundshëm të procedurës, apo 1.4. dëgjimi i palës përjashtohet shprehimisht me ligj.

Më pas gjykata e shkallës së parë i'u ka referuar edhe Rregullores për përcaktimin e llojit të shkeljeve dhe procedurat e mbikëqyrjes etike të OMK Nr.17/2019, e cila në nenin 44 paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar: *1.Shqyrtimi kryesor caktohet me urdhër të kryetarit të Këshillit të Etik, në të cilën shënohet pranimi për shqyrtimin e propozim ankesës apo fletëparaqitjes së prokurorit. 2 Urdhër të kryetarit të Këshillit të Etik shënohen data, kaha dhe vendi i mbajtjes së seancës. 2 Konsiderohet se janë përmbushur kushtet për mbajtjen e senacës së shqyrtimit kryesor nëse ftesat u janë dërguar palëve në mënyrë të rregullt dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për fillimin e seancës. Kështu përkundër këtyre detyrimeve ligjore, nga vendimi i kontestuar dhe vendimi i shkallës së parë e po ashtu nga asnjë nga provat e prezantuara nga e paditura, nuk u vërtetua se paditësi është ftuar për tu dëgjuar lidhur me procedurën disiplinore për shkeljet e Kodit të Etikës për të cilat ishte shpallur përgjegjës dhe sanksionuar nga Këshilli i Etikës, ashtu sic është përcaktuar me dispozitat e nenit 26 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionisteve dhe dispozitat e nenit 95. Dispozitë kjo e nenit 95 të Ligjit për Procedurën Administrative, e që ka të bëjë me thirrjen e palëve, dëgjimin e palëve, përgatitjen e procesverbaleve dhe procedurat tjera, dhe e cila është paraparë si detyrimisht e zbatueshme me Ligjin 04/L-150 konkretisht nenin 26 paragrafi 1 të tij. Përveç se nga e paditura nuk është provuar se paditësi është ftuar në mënyrë të rregullt për tu dëgjuar para Këshillit të Etik, po ashtu me asnjë provë nuk u vërtetua të jetë mbajtur seancë e shqyrtimit kryesor lidhur me rastin e paditësit, sic është paraparë me dispozitat e Rregullorës së OMK nr.17/2019, konkretisht nenin 44 të saj. Prandaj nga e gjithë kjo e konstatuar, gjykata e shkallës së parë vlerëson se e paditura në rastin e paditësit kishte shkelur dispozitat ligjore si më lartë në dëm të tij, dhe në këtë rast janë të bazuar pretendimet e paditësit, kështu që vendimin e nxjerr në këtë mënyrë e konsideron me të meta, për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e cekura më lartë janë të atilla që vendimin e atakuar e bëjnë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin. Andaj, gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë shqyrtoi edhe pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës, lidhur me arsyetimin e vendimit të nxjerr jashtë seancës dhe arsyetimin e tij mbi bazën e nenit 96 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, por të njëjtat pretendime i vlerësoi si të pabazuara, të paargumentuara dhe se të njëjtat nuk gjejnë vend në këtë rast, duke qenë se me Ligjin e OPSH është përcaktuar decidivisht dhe atë nën nenin 26 paragrafi 2 se "Anëtarit të Odës ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore doemos duhet ti mundësohet deklarimi dhe mbrojtja pranë këshillit etik". Që do të thotë se nuk bëhet fjalë për përjashtim të së drejtës së dëgjimit të palës, ngase ky detyrim është i caktuar shprehimisht me ligj.*

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, përgjigjes në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore në ankesë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurale, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurit në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatim jo të plotë të gjendjes faktike duke nxjerr përfundime të tilla se e paditura nuk i ka thënë mundësi paditësit të deklarohet dhe të paraqes mbrojtjen e tij pranë organit kompetent të paditurës. Mirëpo gjykata e shkallës së parë nuk ka marr parasysh fare përmbajtjen e provave që janë administruar dhe të cilat janë propozuar nga e paditura, siç është Raporti i inspektimit specifik i datës 31.05.2019, në të cilin Inspektorati Shëndetësor i cili ka bërë ekzaminimin faktik dhe ka iniciuar procedurën administrative ka dëgjuar drejtpërdrejt paditësin dhe ka siguruar provat materiale të cilat asnjëherë nuk janë kontestuar nga paditësi, siç janë dokumentet shëndetësorë të vulosura nga vula e paautorizuar të cilën e ka poseduar paditësi, si dhe deklaratën të cilën e ka deponuar paditësi me datë 13.05.2019 në të cilën e ka pranuar se vulën e ka prodhuar dhe përdorur në mënyre të pa autorizuar. Pra organi i shkallës së parë i të paditurës me të drejtë ka konsideruar se pala tani me është dëgjuar në procedurë administrative. Andaj me shpërfilljen e provave të tilla gjykata e shkallës së parë ka konstatuar në mënyre jo të plotë gjendjen faktike, gjë e cila ka ndikuar në vendosjen e kësaj çështje. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, meqë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se vendimi i kontestuar përmban të meta të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij, dhe në këtë drejtim gjykata me të drejtë e ka obliguar organin e paditur që në ri procedurë të mënjanohet të metat e cekura. Sepse akti i tillë individual përfundimtar nuk është i plotë dhe përmbajtësor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, ngase përmban të meta esenciale se me asnjë nga provat e prezantuara nga e paditura, nuk u vërtetua se paditësi është ftuar për tu dëgjuar lidhur me procedurën disiplinore për shkeljet e Kodit të Etikës për të cilat ishte shpallur përgjegjës dhe sanksionuar nga Këshilli i Etikës, ashtu sic është përcaktuar me dispozita e nenit 26 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionisteve dhe dispozitat e nenit 95 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, dhe nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata gjen se akti administrativ patjetër duhet të jetë në kuptim të neneve të lartcekura të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionisteve. Prandaj, në një gjendje të tillë të vlerësimit, sipas bindjes edhe të kolegjit të kësaj gjykate e bënë të pa qëndrueshëm vendimin kontestues.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje të konstatuar, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, nga shkak se e paditura me asnjë provë nuk e ka vërtetuar një gjendje të tillë të krijuar për mos mundësinë e vendosjes ashtu siç parashihet me dispozitat e neneve të lartcekura të LPPA-së dhe Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionisteve. Ngase, akti administrativ mund të kontestohet në konfliktin administrativ për shkaqe të paligjshmërisë formale dhe materiale. Shkaqet e paligjshmërisë formale juridike janë, shkelja e rregullave të procedurës që konsistojnë edhe në të metat në formën e aktit dhe në mungesën e arsytimit etj. Ndërsa nga vendimi i kontestuar nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, ngase nuk janë ofruar prova të mjaftueshme dhe bindëse, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, gjithashtu këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi,

sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara dhe pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla esenciale të lartcekura që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Ngase vendimi i kontestuar i të paditurës, duhet të jetë i plotë, përmbajtjesor dhe i arsyetuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Andaj, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, me të cilin ka anuluar vendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.5/2023, me datë 05.01.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi